



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.312/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP), paraqitur kundër subjektit politik Partia Romëve e Bashkuar të Kosovës për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 14.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa Anr. 312/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP)

## A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë Kosovaki Nevi Romani Partia (KNRP) në të cilën thekson se gjatë përfundimit të procesit të votimit si dhe gjatë numërimit të votave kanë vërejtur shumë parregullësi të cilat si rrjedhojë po pasqyrohen në ecurinë e rezultateve në publikuara në web-faqen e KQZ-së. Këto dukuri janë konstatuar sidomos në veprimin e subjektit politik PREBK në komunat si: Obiliq, Prishtinë, Pejë dhe Prizren.

Në këto ecuri të keqpërdorimeve sipas parashtruesit të ankesë janë evidentuar dhe veprimet e organeve të rendit në vendvotimin 1501/E01R Obiliq, ku janë vendosur vota në mënyrë masive në kutit e votimit.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, në kuptim të nenin 117 par. 3 të LZP-së, gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar:**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar ndonjë dëshmi apo provë materiale e cila do ti vërtetonte pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Paneli vlerësoi se ankesa është e pabazuar ngase nuk ka elemente të manipulimit në rastin konkret dhe nuk ka persona të identifikuar lidhur me pretendimet ankimore. Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nën 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 312/2017 më datën 14.06.2017



***Këshillë Juridike:***

*Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*